



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 611/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-74337-10-07-2020, me objekt: “*Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e Plazhit Palasë - Drymadhes*”, me fond limit 525.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.11.2020, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k.  
Adresa: Rr. “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap.3, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr.10, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përçaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të ankimuesit.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.10.2020 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-74337-10-07-2020, me objekt: “Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e Plazhit Palasë - Drymadhes”, me fond limit 525.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.11.2020, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 20.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "Florida" sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
2. "Alb Building" sh.p.k.	323,982,002.46 lekë, skualifikuar
3. "2T" sh.p.k.	414,903,465.50 lekë, skualifikuar
4. "Curri" sh.p.k.	439,756,576.33 lekë, skualifikuar
5. "Gjiguria" sh.p.k.	499,736,229.06 lekë, kualifikuar
6. "G.P.G. Kompany" sh.p.k.	517,129,279.05 lekë, skualifikuar
7. "Fusha" sh.p.k.	522, 129,508.67 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 20.11.2020, operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

*Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. nuk plotëson Kriterin për kapacitetin teknik pika 2.3.1. të Kriterëve të vecantë në DT për objektin "Nderhyrje e integruar për permiresimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e Plazhit Palase - Drymadhes" për sa i përket "Përvajtës së suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme" a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht, kontratat e paraqitura nga Curri sh.p.k. nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është rikualifikim urban, ndërtim mole, shesh dhe shëtitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese në funksion të këtyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, ujësjelles kanalizime, etj*

II.5. Në datën 26.11.2020, operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*[...] Shoqëria "CURRI" Sh.p.k., është ofertues në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në datën 10.11.2020, me objekt: "Nderhyrje e integruar për permiresimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e Plazhit Palase - Drymadhes", me REF-74337-10-07-2020, me fond limit 525,000,000 leke pa TVSH.*

*Autoriteti Kontraktor nepermjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) të prokurimit publik ka bërë kuotimin e ofertave në datën 20.11.2020 si më poshtë:*

1. "Florida" sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
2. "Alb Building" sh.p.k.	323,982,002.46 lekë, skualifikuar
3. "2T" sh.p.k.	414,903,465.50 lekë, skualifikuar
4. "CURRI" sh.p.k.	439,756,576.33 lekë, skualifikuar

5. "Gjikuria" sh.p.k.	499,736,229.06 lekë, kualifikuar
6. "G.P.G. KOMPANY" sh.p.k.	517,129,279.05 lekë, skualifikuar
7. "FUSHA" sh.p.k.	522, 129,508.67 lekë, kualifikuar

Kuotimi i dates 20.11.2020

*Arseye e skualifikimit te publikuar ne SEP, te APP:*

*Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Krieteve te vecante ne DT per objektin "Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes" per sa i perket "Pervojes se sukseshme ne realizimin e puneve te ngjashme" a) Pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedures së prokurimit ose b) Pune të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Konkretisht, kontratat e paraqitur nga Curri sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në nature, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është rikualifikim urban, ndertim mole, shesh dhe shëtitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese në funksion të këtyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, ujesjelles kanalizime, etj*

*Sqarime dhe argumentime:*

*Ne permbushje te kerkesave te pikes 2.3.1. te Krieteve te Vecanta te DST, ne kete procedure prokurimi kemi paraqitur disa kontrata te ngjashme, duke pasur parasysh kete keqintepretim qe mund te behej nga KVO e Autoritetit Kontraktor.*

- 1. Ndertim asfaltim i rruge Cerrik Belsh - Dragot - Kucove - Ure Vajgurore (Segmenti Degezim Grekan-Dragot)*
- 2. Ndertim i Unazes se qytetit, Bashkia Yau i Dejes*
- 3. Rehabilitim i diges se Gjocaj ne HEC Yau i Dejes*
- 4. Rikonstruksion i rruges industriale prane terminalit te doganes se Tiranes, Bashkia Vore*
- 5. Rikonstruksion i rruges nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman*
- 6. Rikonstruksion i rruges Velipoje Plazh, Loti II-te*
- 7. Rikualifikim i sheshit ne Koplík te Siperim*
- 8. Rikualifikim i Qendres Bajze Kastrati, Loti I*
- 9. Rikonstruksion i ujesjellesit te Lagjes "28 Nentori" dhe "Skenderbeu", ne qytetin e Elbasanit*
- 10. Ndertim i Ujesjellesit Cerme - Terbuf – Sulzotaj*
- 11. Ndertim kapanoni industrial, Sharge, Bashkia Vore.*
- 12. Mirembajtje rutine dhe dimerore rruga Qafe Bualli-Kraste 16.7 km*

13. Mirembajtje rutine dhe dimerore me performance e aksit rrugor Qafe Lac=-Koman, 32.4 km
14. Rikonstruksion Kabina Muratire, Fiderat F-321; 322; 324; 325 dhe ndertim i bateris ese re me 8 tubo
15. Godine banimi dhe sherbimesh 8 kat + papfingo + 1 kat parkim nentoke

Ne kete harmonizim kontratash qe kemi paraqitur, gjenden te gjitha llojet e punimeve qe ka preventivi i punimeve ne kontraten objekt prokurimi.

A) Ju, shkruani ne arsyet e skualifikimit se si produkt kerkohet rikualifikim urban, shesh dhe shetitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese ne funksion te ketyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi te ambienteve te jashtem dhe gjelberimi, mobilim urban etj. Ne kemi paraqitur per kete dy kontrata te rikualifikimit urban:

1. Rikualifikim i sheshit ne Koplak te Siperm
2. Rikualifikim i Qendres Bajze Kastrati, Loti I

B) Ju shkruani ne arsyetimet tuaja se duhet edhe ndertim moli.

Po nese anaterat e KVO, nuk jane Inxhinier nuk ka se si ta kuptojne se fjale e madhe "ndertim moli", nuk eshte asgje me shume se sa germim, mbushje me zhavor, apo shpim me Sonda, struktura betoni dhe hekuri. A gjenden keto punime ne kontratat tona te ngjashme? Patjeter qe gjenden te gjitha. Por, kur nuk do t'i shikosh te verbohen syte.

C) Kontrata objekt prokurimi, nuk ka as natyre, as kompleksitet dhe as metodologji te ndryshem nga te gjitha kontratat e realizuara nga ana jone dhe te paraqitura si kontrata te ngjashme ne kete procedure prokurimi.

D) Ne te gjitha rastet e tjera kur keni bere skualifikim te ofertes tone "arsyeja" qe keni dhene ka gene se kemi pas te angazhur stafin apo makinerite. Ndersa ne kete rast, kete arsye nuk mund ta thonit, pra nuk mund te shkruait se kemi te angazhuar stafin dhe makinerite. Dhe, kjo thjeshte sepse kompani GJIKURIA Sh.p.k, qe ju doni te favorizoni ne kete procedure e ka stafin dhe makinerite te angazhuara ne disa kontrata te lidhura edhe me Fondin Shqiptar te Zhvillimit.

E) Ne te gjitha prokurimet e zhvilluara nga FSHZH ne kete periudhe, ofertajone eshte kualifikuar dhe ne kemi deklaruar si kontrata te ngjashme te njejtat kontratat qe kemi deklarua ne kete procedure. Por ne kete rast, nuk ju intereson kualifikimi jone, dhe kerkoni te gjeni arsye te paqene per te na skualifikuar nga kjo procedure dhe per te kualifikuar dhe favorizuar kompanine "GJIKURIA" Sh.p.k., qe ndonse me nje oferte me vlere 60 milion leke te reja me shume, ju perpiqeni ta shpallni fitues te kesaj procedure prokurimi. Autoriteti Kontraktor, nuk mund te veproje me dy standarte. Atje ku nuk i intereson, hen kuotime dhe shpall fitues oferten me te ulet. Ndersa, atje ku eshte i interesuar per te favorizuar oferta te kompanive te miqeve dhe shokeve te Drejtorit te Pergjithshem, i skualifikon ofertat me te ulta dhe favorizon ofertat me vlere me te larte, per intresa te perfitimeve personale.

Z. Kryetar, i Autoritetit Kontraktor, Parimi baze i LPP eshte perdorimi me efektivitet i fondeve publike dhe prandaj skualifikimi i ofertes sone qe eshte oferta me vleren me te ulet vjen ne kundërshtim me kete parim te rendesishem duke i shkaktuar dem ekonomik buxhetit te shtetit. Per sa me siper, Mqs ankesa jone ploteson kushtet formale te ankimit ; ( e kemi paraqitur brenda afatit ligjor, eshte formularin standart dhe mqs kemi interes per kete procedure sepse kemi gene pjesemarrës dhe ofertues ne te) .

**KERKOJME:**

1. Shyrtimin e ankese se paraqitur nga kompania "CURRI" Sh.p.k. dhe kualifikimin e ofertes sone ne kete procedure prokurimi.
2. Pezullimin e procedures deri perfundim te shyrtimit nga cdo hallke e parashikuar ne LPP dhe pranimin e ankeses duke rivleresuar oferten e paraqitur nga shoqeria "CURRI" Sh.p.k.[...].

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.2973/1 prot, datë 02.12.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik "Curri" sh.p.k., duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

[...]Lidhur me pretendimin e OE "Curri" shpk per skualifikimine ofertes se OE veren se:

Ne dokumentet e tenderit, Shtojca I 2, pika 2.3. Kapaciteti teknik, nga ana e autoritetit kontraktor eshte percaktuar kriteri: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme. Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Fatura tatimore përfundimtar te punimeve
5. Akt kolaudimi;

Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Fatura tatimore për situacionin perfundimtar te punimeve.
5. Akt kolaudimi

Nga shyrtimi i dokumentacionit te OE "Curri" shpk, Zyrtari Pergjegjes i Shyrtimit te Ankesave gjykon se, kontratat e paraqitur nga Curri sh.p.k, nuk mund te konsiderohen si kontrata te ngjashme. Ne piken 2.3.1 te DT eshte percaktuar se: "Ngjashmeria e kontratave do te bazohet ne natyren, kompleksitetin dhe/ose karakteristika te tjera te pershkruara ne raportin teknik". OE per te deshrnuar se ploteson kriterin per pune te ngjashme te se njejtes natyre ka paraqitur kontratat

- 1.Ndertim asfaltim i rruge Cerrik Belsh - Dragot - Kucove - Ure Vajgurore (Segmenti Degezim Grekan-Dragot)
- 2.Ndertim i Unazes se qytetit, Bashkia Yau i Dejes
- 3.Rehabilitim i diges se Gjocaj ne HEC Yau i Dejes
- 4.Rikonstruksion i rruges industriale prane terminalit te doganes se Tiranes, Bashkia Vore
- 5.Rikonstruksion i rruges nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman
- 6.Rikonstruksion i rruges Velipoje Plazh, Loti II-te
- 7.Rikualifikim i sheshit ne Kopluk te Siperm
- 8.Rikualifikim i Qendres Bajze Kastrati, Loti I
- 9.Rikonstruksion i ujesjellesit te Lagjes "28 Nentori" dhe "Skenderbeu", ne qytetin e Elbasanit
- 10.Ndertim i Ujesjellesit Cerme - Terbuf – Sulzotaj
- 11.Ndertim kapanoni industrial, Sharge, Bashkia Vore.
- 12.Mirembajtje rutine dhe dimerore rruga Qafe Bualli-Kraste 16.7 km
- 13.Mirembajtje rutine dhe dimerore me performance e aksit rrugor Qafe Lac=-Koman, 32.4 km
- 14.Rikonstruksion Kabina Muratire, Fiderat F-321; 322; 324; 325 dhe ndertim i bateris ese re me tubo

15.Godine banimi dhe sherbimesh 8 kat + papfingo + 1 kat parkim nentoke

Zyrtari Pergjegjes i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se keto kontrata jane te nje natyre qe kane te bejne me infrastrukturen e transportit rrugor (rikonstruksion rruges) ujesjelles kanalizime, etj. dhe nuk mund te konsiderohen si kontrata te ngjashme, pasi nuk permbushin karakteristikat e kontrates ne natyre, kompleksitet dhe metodologji. Ashtu sic eshte theksuar dhe ne argumentimin e KVO, produkti qe kerkohet ne objektin e prokurimit eshte rikualifikim urban, ndertim mole, shesh dhe shetitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese ne funksion te ketyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi te ambienteve te jashtem dhe gjelberimi, mobilim urban etj.

Ne nenin 46, pika 1 gerrna "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatore: ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vleteson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e komrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;"

Ndersa ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit."

Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetern ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te

detyrueshme per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Sa me siper pretendimi i OE ankimues nuk qendron.[...]

II.7. Në datën 09.12.2020 operatori ekonomik “Curri” sh.p.k.. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]Shoqeria "CURRI" Sh.p.k., eshte ofertues ne proceduren e prokurimit te zhvilluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ne daten 10.11.2020, me objekt:"Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes", me REF-74337-10-07-2020, me fond limit 525,000,000 leke pa TVSH.

Autoriteti Kontraktor nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik (SPE) te prokurimit publik ka here kuotimin e ofertave ne daten 20.11.2020 si me poshte:

1.	“Florida” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
2.	“Alb Building” sh.p.k.	323,982,002.46 lekë, skualifikuar
3.	“2T” sh.p.k.	414,903,465.50 lekë, skualifikuar
4.	“CURRI” sh.p.k.	439,756,576.33 lekë, skualifikuar
5.	“Gjiguria” sh.p.k.	499,736,229.06 lekë, kualifikuar
6.	“G.P.G. KOMPANY” sh.p.k.	517,129,279.05 lekë, skualifikuar
7.	“FUSHA” sh.p.k.	522, 129,508.67 lekë, kualifikuar

Kuotimi i dates 20.11.2020

Arseye e skualifikimit te publikuar ne SEP, te APP:

Operatori ekonomik “Curri” shp.k nuk ploteson kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT per objektin “Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes” per sa i perket "Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Konkretisht, kontratat e paraqitur nga Curri sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në nature, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti qe kërkohet në objektin e prokurimit është rikualifikim urban, ndertim mole, shesh dhe shëtitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese në funksion të këtyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, ujësjes kanalizime, etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej o janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor ujësjes kanalizime etj.

Sqarime dhe argumentime:



*Ne permbushje te kerkesave te pikes 2.3.1. te Kritereve te Vecanta te DST, ne kete procedure prokurimi kemi paraqitur disa kontrata te ngjashme, duke pasur parasysh kete keqintrepretim qe mund te behej nga KVO e Autoritetit Kontraktor.*

*1.Ndertim asfaltim i rruge Cerrik Belsh - Dragot - Kucove - Ure Vajgurore (Segmenti Degezim Grekan-Dragot)*

*2.Ndertim i Unazes se qytetit, Bashkia Yau i Dejes*

*3. Rehabilitim i diges se Gjocaj ne HEC Yau i Dejes*

*4.Rikonstruksion i rruges industriale prane terminalit te doganes se Tiranes, Bashkia Vore*

*5.Rikonstruksion i rruges nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman*

*6. Rikonstruksion i rruges Velipoje Plazh, Loti II-te*

*7.Rikualifikim i sheshit ne Koplík te Siperim*

*8.Rikualifikim i Qendres Bajze Kastrati, Loti I*

*9.Rikonstruksion i ujesjellesit te Lagjes "28 Nentori" dhe "Skenderbeu", ne qytetin e Elbasanit*

*10.Ndertim i Ujesjellesit Cerme - Terbuf – Sulzotaj*

*11.Ndertim kapanoni industrial, Sharge, Bashkia Vore.*

*12.Mirembajtje rutine dhe dimerore rruga Qafe Bualli-Kraste 16.7 km*

*13. Mirembajtje rutine dhe dimerore me performace e aksit rrugor Qafe Lac-Koman, 32.4 km*

*14.Rikonstruksion Kabina Muratire, Fiderat F-321; 322; 324; 325 dhe ndertim i baterise se re me 8 tubo*

*15.Godine banimi dhe sherbimesh 8 kat + papfingo + 1 kat parkim nentoke.*

*Ne kete harmonizim kontratash qe kemi paraqitur, gjenden te gjitha llojet e punimeve qe ka preventivi i punimeve ne kontraten objekt prokurimi.*

*A) Ju, shkruani ne arsyet e skualifikimit se si produkt kerkohet rikualifikim urban, shesh dhe shetitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese ne funksion te ketyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi te ambienteve te jashtem dhe gjelberimi, mobilim urban etj. Ne kemi paraqitur per kete dy kontrata te rikualifikimit urban:*

*1. Rikualifikim i sheshit ne Koplík te Siperim*

*2. Rikualifikim i Qendres Bajze Kastrati, Loti I*

*B) Ju shkruani ne arsyetimet tuaja se duhet edhe ndertim moli.*

*Po nese anaterat e KVO, nukjane Inxhinier nuk ka se si ta kuptojne se fjale e madhe "ndertim moli", nuk eshte asgje me shume se sa germim, mbushje me zhavor, apo shpim me Sonda, struktura betoni dhe hekuri.*

*A gjenden keto punime ne kontratat tona te ngjashme? Patjeter qe gjenden te gjitha. Por, kur nuk do t'i shikosh te verbohen syte.*

*C) Kontrata objekt prokurimi, nuk ka as natyre, as kompleksitet dhe as metodologji te ndyshem nga te gjitha kontratat e realizuara nga ana jone dhe te paraqitura si kontrata te ngjashme ne kete procedure prokurimi.*

*D) Ne te gjitha rastet e tjera kur keni bere skualifikim te ofertes tone "arsyeja" qe keni dhene ka gene se kemi pas te angazhuar stafin apo makinerite. Ndersa ne kete rast, kete arsye nuk mund ta thonit, pra nuk mund te shkruait se kemi te angazhuar stafin dhe makinerite. Dhe, kjo thjeshte sepse kompani GJIKURIA Sh.p.k, qe ju doni te favorizoni ne kete procedurë e ka stafin dhe makinerite te angazhuara ne disa kontrata te lidhura edhe me Fondin Shqiptar te Zhvillimit.*

E) Ne te gjithë prokurimet e zhvilluara nga FSHZH ne kete periudhe, oferta jone eshte kualifikuar dhe ne kemi deklaruar si kontrata te ngjashme te njejtat kontratat qe kemi deklaruar ne kete procedure. Por ne kete rast, nuk ju intereson kualifikimi jone, dhe kerkoni te gjeni aresye te paqene per te na skualifikuar nga kjo procedure dhe per te kualifikuar dhe favorizuar kompanine "GJIKURIA" Sh.p.k., qe ndonse me nje oferte me vlere 60 milion leke te reja me shume, ju perpiqeni ta shpallni fitues te kesaj procedure prokurimi.

Autoriteti Kontraktor, nuk mund te veproje me dy standarte. Atje ku nuk i intereson, ben kuotime dhe shpall fitues oferten me te ulet. Ndersa, atje ku eshte i interesuar per te favorizuar oferta te kompanive te miqeve dhe shokeve te Drejtorit te Pergjithshem, i skualifikon ofertat me te ulta dhe favorizon ofertat me vlere me te larte, per intresa te perfitimeve personale.

*Te nderuar anetare te KPP!*

Parimi baze i LPP eshte perdorimi me efektivitet i fondeve publike dhe prandaj skualifikimi i ofertes sone qe eshte oferta me vleren me te ulet vjen ne kundershtrim me kete parim te rendesishem duke i shkaktuar dem ekonomik buxhetit te shtetit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne Autoritetit Kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur, duhet te vertetojne se gezojne te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim Autoriteti Kontraktor, nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formate por dhe te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesi ne funksion te qellimit dhe rrethaneve faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara. Ne kuptim dhe ne qellim te ligjit, eshte e rendesishme qe te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetin teknik dhe licencat lidhur me pervojen e kerkuar (sikurse perckatura ne nenin 46 te LPP), vertetuar kjo nepermjet dokumenteve te tilla si kontrata te ngjashme shoqeruar me dokumentacionin perkates, sic eshte rasti i dokumentacionit te paraqitur nga shoqeria CURRI Sh.p.k., ne kete procedure prokurimi. Autoriteti Kontraktor ne shyrtimin e kontratave te paraqitura per eksperianca te ngjashme te meparshem, duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje edhe te gjithë zerat e puneve, te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare. **AUTORITETI KONTRAKTOR, NUK DUHET TE PRETENDOJE PER ZERA TE NJEJTE PUNESH DHE TE KERKOJE EKSPERIENCA TE NJEJTA, NE KUNDERSHTIM ME RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK.**

As ne arsyetimin e dhene nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por as edhe ne Pergjigjen e dhene nga KSHA e Autoritetit Kontraktor, nuk thuhet dhe as qe eshte bere nje analize se cilat zera te punimeve ne nuk plotesojme, cilat zera te punimeve te kontrates objekt prokurimi nuk perputhet me kontratat e ngjashme qe ne kemi paraqitur. Por, ne pergjigjen e dhene, thjeshte citojne e stercitojne nje fraze te pakuptimte "Ngjashmeria e Kontratave do te bazohet ne natyren kompleksitetin dhe karakteristika te tjera te pershkruara ne raportin teknik".

Ky vleresim i bere nga KVO e me pas i lene ne fuqi dhe nga KSHA e titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk eshte aspak profesional, eshte i pambeshtetur ne ligj dhe totalisht ne kundershtrim me frymen dhe parimet e Ligjit te Prokurimit Publik.

Autoriteti kontraktor ka cenuar rende parimet e sanksionuara ne ligjin 9643/2006 te cilat jane: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose candidateve; b) transparence në

*procedurat e prokurimit; c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.*

*Por kjo nuk e ka penguar Autoritetin Kontraktor qe ta kualifikoje. KPP eshte e lutur te verifikoje kete informacion dhe te nxjerre perfundimet e saj ne vleresimin e ankeses tone. Shoqeria "CURRI" sh.p.k eshte nje shoqeri lider ne fushen e ndertimeve dhe pjesemarrrese e rregullt ne procedurat e prokurimit te organizuara nga autoritete te ndryshme kontraktore. Kjo shoqeri nder vite ka rezultuar e sukseshme ne procedurat e prokurimit, ka nenshkruar me qindra kontrata sipermarrje dhe ka finalizuar objekte dhe pune te nje cilesie te larte dhe me standarde bashkekohore.[...]*

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 2973/3 prot., datë 18.12.2020, protokolluar me tonën në datën 22.12.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen: *“Operatori ekonomik “Curri” shp.k nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Krieteve te vecante ne DT per objektin “Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes” per sa i perket “Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht, kontratat e paraqitura nga Curri sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në nature, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti qe kërkohet në objektin e prokurimit është rikualifikim urban, ndertim mole, shesh dhe shëtitore, ambiente rekreacioni, infrastrukture ndihmese në funksion të këtyre ambienteve (si, sisteme vaditje, punime/instalime pajisje elektro-mekanike), punime sistemimi të ambienteve të jashtëm dhe gjelbërimi, mobilim urban etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, ujeshelles kanalizime, etj,” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1. “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

ose b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme.

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

2. Kontratën/at e Sipërmarrjes

3. Situacionin përfundimtar të objektit;

4. Fatura tatimore përfundimtar te punimeve

5. Akt kolaudimi;

Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:

2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;

3. Situacionin përfundimtar të objektit;

4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar te punimeve.

5. Akt kolaudimi

Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontrata baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe

- Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor”

III.1.2. Në relacionin teknik, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë vijon:

“Ky projekt parashikon

1.Ndertimin e rruges, nje parkim publik, molin, si dhe plazhin publik ne Dhrale;

2. *Ndertimin e rruges, shetitoren, nje parkim publik dhe molin ne Livadh.*

3. *Moli ne Drimadhe*”

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ”Curri” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë nr. 3985/5 prot., datë 13.09.2018, lidhur ndërmjet Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Rehabilitim i Digës së Gjocaj në Hec Vau i Dejës”, me vlerë 23,828,359.2 lekë, shoqëruar me, kërkesë për certifikim nr. 115 prot., datë 18.12.2018, situacion nr. 3, akt kolaudimi nr. 3985/19prot., datë 21.12.2018, certifikatë e marrjes në dorëzimnr.3985/20prot., datë 21.12.2018, Formular Vlerësimi nr. 6037 datë 27.12.2019, lëshuar nga autoriteti kontraktor Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a, e përmbushur po.

Kontratë nr. 3349/12 prot., datë 22.05.2019 lidhur ndërmjet Bashkia Shkodër dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Loti i Dyte Rikonstruksion Ruge Velipoje Plazh Loti i II-te”, me vlerë 39,866,422 lekë (pa tvsh), Financimi per vitin 2019 do te jete 28,345,000 leke pa tvsh, Financimi per vitin 2020 do te jete 8,467,500 leke pa tvsh, Financimi per vitin 2021 do te jete 3,053,922 leke pa tvsh, shoqëruar me situacion nr. 1, situacion nr.2 përfundimtar, procesverbal akt kolaudimi, akt – kolaudim tekniko-ekonomik, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve datë 28.08.2019, fatura tatimore, Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, e përmbushur po 100%

Formular Vlerësimi, shoqëria e ndërtimit Curri shpk vlere e realizuar 387,800,968 lekë, e përmbushur, Vendim KKRT nr. 37 datë 26.09.2008, objekti: Godinë banimi e shërbimesh 8 kat plus papafingo+1 kat parking nëntokë, leje ndërtimi, vendim Nr.16409 Prot. Datë 05.10.2018, fatura tatimore, situacion 5 progresiv datë 30.12.2019, situacion përfundimtar (karabina) datë 01.09.2020,akt kolaudimi tekniko ekonomik, akt kolaudimi tekniko ekonomik(faza e karabinasë,akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, vlerësimi: Kryer me cilësi të mirë, projekti dhe ndryshimet e miratuara janë zbatuar në mënyrë korrekte duke zbatuar kushtet teknike të zbatimit në fuqi. Kontratë nr 4077 prot., datë 02.10.2017 lidhur ndërmjet Bashkia Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Rikualifikim i Qendrës Bajzë Kastrati Loti i parë”, me vlerë të realizuar 99,786,377 lekë me tvsh, për vitin 2017 30,000,000 lekë me tvsh, për vitin 2018 69,789,752 lekë me tvsh shoqëruar me, situacion përfundimtar, akt – kolaudim tekniko-ekonomik, certifikatë e perkohshme e marjes në dorëzim datë 23.11.2019.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, e përmbushur po. Kontratë referenca P/Punë/2017/GOA/P73 datë 10.05.2017 lidhur ndërmjet Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Ndërtim I Unazës së Qytetit Bashkia Vau Dejës”, me vlerë të realizuar 178,959,589

lekë me tvsh, shoqëruar me situacion përfundimtar, situacion pjesor i punimeve nr. 4, akt – kolaudim, certifikatë e marrjes në dorëzim datë 09.03.2018, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, e përmbushur po. Kontratë 4618prot., datë 17.07.2018 lidhur ndërmjet Bashkia Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Rikualifikimi i sheshit në Koplík të sipërm”, me vlerë të realizuar 9,981,000 lekë (me tvsh), per vitin 2018 do te jete 2,500,000 leke pa tvsh, per vitin 2019 do te jete 3,500,000 leke pa tvsh, per vitin 2020 do te jete 3,983,328 leke pa tvsh, shoqëruar me, situacion përfundimtar, akt – kolaudim, certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve datë 12.10.2018,

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, vlera e realizuar 453,008,801 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë referenca P/Punë/2016/FZHR/P 61 datë 30.11.2016 lidhur ndërmjet Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Ndërtim i ujësjellësit Cermë-Tërbuf Sulzotaj”, me vlerë 378,230,996 lekë (pa tvsh), shoqëruar me, situacion përfundimtar, procesverbal kolaudimi, certifikatë e përfundimit të Punimeve, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, vlera e realizuar sipas situacionit për kontratën bazë 130,106,530 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë nr. 14800/7 datë 27.09.2017 lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Rikonstruksion i Infrastrukturës Rrugore të Bllokut të kufizuar nga rrugët Zogu i I-rë, Rruga e Dibrës-Siri Kodra dhe Reshit Petrela”, me vlerë 130.526.621 lekë (me tvsh), shoqëruar me, situacion përfundimtar, procesverbal kolaudimi tekniko ekonomik, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, vlera e realizuar 30,025,128 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë nr. 4547/5 datë 05.09.2016 lidhur ndërmjet Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Mirëmbajtje Rutinë Dimërore me Performancë aksi rrugor Qafë Lac-Koman 32.4km”, me vlerë 30,375,775.32 lekë (me tvsh), shoqëruar me, situacion përfundimtar nr. 24, akt marrje në dorëzim, fatura tatimore,

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, vlera e realizuar 381,860,850 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë referenca P/Punë/2017/GOA/P 64 datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Ndërtim Asfaltim i Rrugës Cërrik Belsh- Dragot Kucovë-Urë Vajguore(Segmenti Degëzim Grekan-Dragot”, me vlerë 318,219,526 lekë (pa tvsh), shoqëruar me, akt kolaudimi, situacion përfundimtar, procesverbal kolaudimi, certifikatë e përfundimit të Punimeve, fatura tatimore

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Vorë, vlera e realizuar 34,613,328 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë nr. 5693/5 datë 14.02.2019 lidhur

ndërmjet Bashkia Vorë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Rikonstruksion i rrugës industriale pranë terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë”, me vlerë 34,613,372 lekë (me tvsh), financimi për vitin 2019: 1,000,000 lekë me tvsh, për vitin 2020 9,000,000 lekë me tvsh dhe diferenca në varësi të ofertës fituese për vitin 2021 shoqëruar me, situacion përfundimtar punimesh, procesverbal kolaudimi tekniko ekonomik datë 01.07.2019, certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim datë 04.07.2019, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sha, nr. 488/1 datë 27.08.2020 vlera e realizuar 353,469,772.6 lekë me tvsh (JV 82% Curri shpk dhe 18% Inerte Exposs) e përmbushur.

Kontratë nr. 10028/9 datë 31.08.2018 lidhur ndërmjet Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sha dhe boe “Curri” sh.p.k. & “Inerte Express me objekt: “Rikons. Kab. Muraturë, Fiderat F-321;322;324;325; dhe ndërtimi I baterisë së re me 8tubo (seg.N/ST-Rr.Sulejman Delvina) dhe shtrirja e 5 Fiderave të rinj Fiderat /F 324/1;324/2;326/1;2326/2;322/1”, me vlerë 299,151,858 lekë (PA tvsh), shoqëruar me, kontratë bashkimi i përkohshëm i shoqërive, prokurë e posacme, situacion total (1+2+3+4+fondi rezervë), akt kolaudimi, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, lëshuar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, vlera e realizuar 23,385,744 lekë me tvsh e përmbushur po. Kontratë nr. 4541/5 datë 21.09.2016 lidhur ndërmjet Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. me objekt: “Mirëmbajtje Rutinë Dimërore rruga Qafë Bualli-Krastë 16.7km”, me vlerë 23,386,318.92 lekë (me tvsh), shoqëruar me, situacion përfundimtar nr. 24, procesverbal i përfundimit të punimeve, akt marrje në dorëzim, fatura tatimore.

Formular Vlerësimi, investitori Curri shpk , vlera e realizuar 45,227,835.72 lekë me tvsh e vlerësimi kryer me cilësi të mirë. Projekti dhe ndryshimet e miratura janë zbatuar në mënyrë korrekte duke respektuar kushtet teknike të zbatimit. Objekti: Ndërtim kapanoni industrial Shargë Bashkia Vorë. Leje ndërtimi nr. 0409/6 datë 01.03.2018 lëshuar nga Bashkia Vorë, shoqëruar plani I vendosjes së strukturës, marrëveshje për sipërmarrje punimesh ndërtimi datë 02.03.2018, akt kolaudimitekniko ekonomik nr. 01 datë 01.04.2019, certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve datë 01.04.2019, faturë tatimore, certifikatë për vërtetim pronësie 2055659 harta kadastrale

Formular Vlerësimi nr. 3632 datë 02.07.2018, lëshuar nga autoriteti kontraktor Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a, e përmbushur po, object Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e Hec Koman, vlera e realizuar: 319,369,669 lekë me tvsh (JV SMO Union shpk 70%; CURRI shpk 30%)

Kontratë nr 4269/8 prot., datë 09.10.2017 lidhur ndërmjet Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “SMO Union”shpk & “CURRI” shpk me objekt: “Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e Hec Koman”, me vlerë 266,142,909 lekë (pa tvsh), shoqëruar me, kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë, prokurë e posacme nr. 456Rep; nr. 70 Kol,

situacion nr. 5 përfundimtar, akt kolaudimi nr. 3552/1prot. Datë 02.07.2018, certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve, faturë tatimore.

Formular Vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, objekt Rikonstruksion i Ujësjetës të Lagjes 28 Nëntori dhe Skëndërbeu në qytetin e Elbasanit, vlera e realizuar: 474,306,310 lekë me tvsh. Vlerësimi: Projekti dhe ndryshimet e miratura janë zbatuar dhe korrektësi duke zbatuar Kushtet Teknike të Zbatimit (KTZ) në fuqi. Punimet janë realizuar me cilësi të mirë dhe brenda afateve të miratuara nga autoriteti kontraktor. Kontratë nr 1703 prot., datë 19.06.2017 lidhur ndërmjet Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe operatorit ekonomik "CURRI" shpk me objekt: "Rikonstruksion i Ujësjetës të Lagjes 28 Nëntori dhe Skëndërbeu në qytetin e Elbasanit", me vlerë 395,437,204 lekë (pa tvsh), shoqëruar me situacion përfundimtar, akt kolaudimi punimesh, faturë tatimore.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.1.5. Në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet: *"6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve."*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të



cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se ankimuesi, dëshmon se ka kryer punime të ngjashme vetëm për një pjesë të projektit, e cila lidhet vetëm me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, shesheve, sinjalistikës, kanalizimeve etj, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për ndërtimin e moleve (do ndërtohen tre të tillë), infrastrukturave të plazheve apo platformave lundruese ujore (Lilypad), të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimuesi me anë të kontratave të sipërcituara, pasi edhe metodologjia e ndërtimit të tyre është e ndryshme, ku sipas parashikimeve në relacionin teknik do të kryhen punime në prezencë të ujit, me polumbarë etj. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi. Gjithashtu, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Akoma më tej, Komisioni gjykon se objektet “Godinë banimi e shërbimesh 8 kat plus papafingo+1 kat parking nëntokë”; “Mirëmbajtje Rutinë Dimërore me Performancë aksi rrugor Qafë Lac-Koman 32.4km”; “Rikons. Kab. Muraturë, Fiderat F-321;322;324;325; dhe ndërtimi I baterisë së re me 8tubo (seg.N/ST-Rr.Sulejman Delvina) dhe shtrirja e 5 Fiderave të rinj Fiderat /F 324/1;324/2;326/1;2326/2;322/1”; “Mirëmbajtje Rutinë Dimërore rruga Qafë Bualli-Krastë 16.7 km”; “Ndërtim kapanoni industrial Shargë Bashkia Vorë”, nuk mund të konsiderohen aspak si kontrata të ngjashme. Në këto kushte, operatori ekonomik nuk përmbush as vlerën prej 200 % të fondit limit të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për kontratën objekt prokurimi, pasi nga përlllogaritja e vlerave pa tvsh, të punimeve të kryera brenda 3 viteve, pra nga viti 2018 e në vijim, për objektet “Rehabilitim i Digës së Gjocaj në Hec Vau i Dejës”; “Loti i Dyte Rikonstruksion Rruge Velipoje Plazh Loti i II-te”; “Ndërtim I Unazës së Qytetit Bashkia Vau Dejës”; “Rikualifikimi i sheshit në Koplík të sipërm”; “Ndërtim i ujësjellësit Cermë-Tërbuf Sulzotaj”; “Rikonstruksion i Infrastrukturës Rrugore të Bllokut të kufizuar nga rrugët Zogu i I-rë, “Rruga e Dibrës-Siri Kodra dhe Reshit Petrela”; “Ndërtim Asfaltim i Rrugës Cërrik Belsh-Dragot Kucovë-Urë Vajgurore(Segmenti Degëzim Grekan-Dragot”; “Rikonstruksion i rrugës

industriale pranë terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë”; “Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e Hec Koman”; “Rikonstruksion i Ujësjllësit të Lagjes 28 Nëntori dhe Skëndërbeu në qytetin e Elbasanit”, nuk përmbushet vlera prej 1,050,000,000 lekë pa tvsh. Në këto kushte, KPP gjykon se, për sa kohë, operatori ekonomik ”Curri” sh.p.k., me anë të dokumentacionit të paraqitur, nuk plotëson as pikën “a” dhe as pikën “b” të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, atëherë nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.1 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Curri” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-74337-10-07-2020, me objekt: “Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e Plazhit Palasë - Drymadhes”, me fond limit 525.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.11.2020, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1649 Protokolli Datë 09.12.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**